

AKT THEMELIMI

ONE ON CALL

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot, me date 02/08/2023, ne Tirane, Znj. Greta Likaxhiu, person me shtetesi shqiptare, e datelindjes 16/11/1994, mbajtese e dokumentit te identifikimit me numer personal J46116005K, me zotesi te plote juridike per te vepruar nenshkruan kete akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ONE ON CALL

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaku themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tyre eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte ONE ON CALL

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e statutit dhe aktiti te themelimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

4.1 Veprimtaria e shoqerise ONE ON CALL do te kete per objekt:

4.2 Telemarketing-Call Center, perbrenda (inbound) dhe jashte(outbound), brenda vendit dhe nderkombetare. Sherbime telemarketingu on line, te çdo forme dhe tipi, direkt

apo indirekt lidhur me sherbimet e telefonise apo sherbimit fiks. Sherbime marketing, sherbimesh apo produktesh duke mos u limituar vetem ne to. Promocione te ndryshme nepermjet telefonise.

4.3 Shoqeria, me vendim te administratorit, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

4.4 Per te realizuar qellimet e saj, shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortaket, nga vende te tjera, ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te ortakut.

Neni 5

Selia

Shoqeria ONE ON CALL e ka seline ne adresen:

TIRANE; Kompleksi "Halili",rruga e Dibrës,pranë Vila Goldi,Nr.229; me zone kadastrale 8370 kati i 3(trete), hyrja 3

Ne kete adrese do te ushtrohet aktiviteti kryesor i shoqerise.

Neni 6

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.

Neni 7

Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 (njqind) leke.

Neni 8

Administrimi

Administrator i shoqerise do te jete:

Znj. Greta Likaxhiu, person me shtetesi shqiptare, e datelindjes 16/11/1994, mbajtese e dokumentit te identifikimit me numer personal J46116005K. Afati i emerimit te administratorit do te jete per nje periudhe 5 vjecare nga data 02/08/2023 deri me date 01/08/2028

Neni 9

Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

Neni 10

Te ardhurat neto

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapital. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes se detyrimeve tatimore dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne pasqyrat dhe raportet financiare tec do viti financiar, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise, ose mund te rrinvestohen si kapital i shoqerise.

Neni 11

Juridiksioni

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te linden gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre jane gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ONE ON CALL eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruset nga ortakët themelues.

ORTAK I SHOQERISE

ONE ON CALL

GRETA LIKAXHIU